

VENDIM
Nr. 873, datë 27.12.2006

**PËR MASËN E FINANCIMIT, KRITERET DHE PROCEDURAT E ZBATIMIT TË
PROGRAMEVE TË PRAKTIKAVE PROFESIONALE PËR PUNËKËRKUESIT E
PAPUNË, QË KANË MBARUAR ARSIMIN E LARTË, BRENDA APO JASHTË
VENDIT**

(Ndryshuar me VKM nr. 187, datë 2.4.2014)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5 të nenit 9 të ligjit nr. 7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfshirjen në programet e praktikave profesionale në institucione/ndërmarrje, publike apo private, të punëkërkuesve të papunë, të cilët:

- a) kanë përfunduar arsimin e lartë, brenda apo jashtë vendit;
- b) kanë më pak se 24 muaj, që i kanë përfunduar këto studime.

Përfshirja e punëkërkuesve në programet e praktikave profesionale bëhet duke pasur parasysh vendbanimin e tyre.

Zyra përkatëse e punësimit bën njoftimin në Buletinin e Njoftimeve Publike, çdo vit, për fondin e vënë në dispozicion dhe kriteret e përfutimit nga ky program. Publikimi i programit bëhet gjithashtu me të gjitha mjetet e mundshme elektronike dhe joelektronike.

2. Rektoratet, brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të dërgojnë në zyrat përkatëse të punësimit *numrin* e të diplomuarve në 24 muajt e fundit. Gjithashtu, në çdo fund viti akademik, rektoratet janë të detyruara t’i përditësojnë listat e të diplomuarve.

Zyrat përkatëse të punësimit krijojnë listat për personat e diplomuar jashtë vendit, bazuar në njohjen e diplomës nga *Ministria e Arsimit dhe Sportit*.

3. Zyrat përkatëse të punësimit hartojnë listën e punëkërkuesve të papunë, të cilët plotësojnë kushtet për pjesëmarrje në programin e praktikave profesionale dhe i regjistrojnë ato, sipas kodeve të profesioneve dhe datës së regjistrimit në këto zyra.

4. Përzgjedhja e tyre në këto programe bëhet në zyrat përkatëse të punësimit, me përparësi, si më poshtë vijon:

- a) sipas rezultateve, të arritura gjatë viteve të studimit;
- b) nëse janë nga familje, që mbështeten me ndihmë ekonomike;
- c) sipas grupeve të veçanta.

5. Zyrat përkatëse të punësimit, nëpërmjet Shërbimit Kombëtar të Punësimit, hartojnë listat e institucioneve/ndërmarrjeve, publike dhe private, pasi të kenë ndërmjetësuar me këto të fundit për numrin e punëkërkuesve, që do të pranojnë, dhe i bëjnë publike ato. Një kopje e listave u dërgohet rektorateve përkatëse, për t’i shpallur ato në mjediset e fakulteteve.

6. Punëdhënësit publikë janë të detyruar t’i marrin falas në mjediset e tyre këta punëkërkues.

7. Punëdhënësit mund të aplikojnë për programin në mënyrë elektronike apo pranë zyrave të punësimit.

8. Punëdhënësi lëshon një vlerësim pune për periudhën e praktikës profesionale dhe njofton zyrën e punësimit për përfundimin e programit.

9. Gjatë periudhës së praktikës profesionale, punëkërkuesit marrin një mbështetje financiare për çdo muaj praktikë profesionale, deri në 6 muaj, në varësi të periudhës së praktikës profesionale të kryer, nga zyra përkatëse e punësimit, si dhe kontributin për sigurimin nga aksidentet në punë, në masën 0.5 për qind të pagës minimale. Vlera e këtij kontributi derdhet në

degën e sigurimeve shoqërore.

Masa e mbështetjes financiare është 100 për qind e nivelit bazë të pagesës së papunësisë.

10. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor, zëri “Nxitja e punësimit”, i *Ministritë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë*.

11. Ngarkohen *Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë* dhe Shërbimi Kombëtar i Punësimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 shkurt 2007.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha